REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ . _____ . 2026

PËR

MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E SISTEMIT "KUJDESI I DUHUR", TË RREGULLOREVE FLEGT DHE EUDR, SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE DHE INSTITUCIONEVE PËRKATËSE[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës b, të pikës 8 të nenit 27 dhe pikës 4, të nenit 28, të ligjit nr. 57/2020, "Për Pyjet", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe objekti

1. Ky vendim ka për qëllim miratimin e rregullave dhe procedurave për zbatimin e sistemit "kujdesi i duhur", në përputhje me përcaktimet e rregullores EUDR dhe FLEGT si dhe përcaktimin e autoriteteve dhe institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tyre, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

[1] Ky vendim përafron plotësisht *Rregulloren (BE) 2023/1115 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 31 maj 2023, "Mbi vënien në dispozicion në tregun e BE-së dhe eksportin nga BE-ja të mallrave dhe produkteve të caktuara që lidhen me shpyllëzimin dhe degradimin e pyjeve, si dhe për shfuqizimin e Rregullores (BE) nr. 995/2010"* dhe *rregulloren e Këshillit (KE) nr. 2173/2005, datë 20 dhjetor 2005 "Mbi ngritjen e një skeme licencimi FLEGT për importin e lëndës drusore në Komunitetin Evropian", të ndryshuar*

2. Ky vendim përcakton:
   a) rregullat dhe procedurat për dokumentimin, gjurmueshmërinë, kontrollin dhe verifikimin e përputhshmërisë së mallrave përkatëse dhe produkteve përkatëse sipas kërkesave të Rregullores (BE) 2023/1115;
   b) rregullat dhe procedurat për zbatimin e sistemit "kujdesi i duhur" nga operatorët, operatorët pasues dhe tregtarët, sipas parashikimeve të këtij vendimi;
   c) rregullat dhe procedurat për verifikimin e licencave FLEGT për importet e produkteve të drurit nga vendet që zbatojnë skemën përkatëse sipas Rregullores nr. 2173/2005;
   ç) autoritetin kompetent dhe institucionet përgjegjëse për bashkërendimin, kontrollin, inspektimin, verifikimin, raportimin dhe shkëmbimin e informacionit në kuadër të zbatimit të këtij vendimi;
   d) procedurat e bashkërendimit ndërinstitucional për zbatimin e akteve të Bashkimit Evropian në fushën e mallrave dhe produkteve që lidhen me shpyllëzimin dhe degradimin e pyjeve, për aq sa bëhen të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.
3. Ky vendim kontribuon në parandalimin e shpyllëzimit dhe degradimit të pyjeve, reduktimin e ndikimeve negative mbi klimën dhe biodiversitetin, si dhe në garantimin që mallrat përkatëse dhe produktet përkatëse të vendosura në treg ose të eksportuara të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky vendim zbatohet për detyrimet e operatorëve, operatorëve pasues dhe tregtarëve për hedhjen në treg, vënien në dispozicion në treg, importin dhe eksportin e mallrave përkatëse dhe produkteve përkatëse, sipas parashikimeve të këtij vendimi.
2. Përjashtimisht, për lëndën drusore dhe prodhimet e drurit të prodhuara para datës 29 qershor 2023 dhe të hedhura në treg nga data 30 dhjetor 2026, deri më 31 dhjetor 2029 nuk zbatohen kërkesat e këtij vendimi për statusin 'pa lidhje me shpyllëzimin', gjeolokacionin dhe deklaratën e kujdesit të duhur; këto kërkesa zbatohen për to nga data 31 dhjetor 2029.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
1. "autoritet licencues" është autoriteti i caktuar nga vendi partner për të lëshuar dhe vlefësuar licencat FLEGT;
2. "autoritet kompetent" është çdo institucion përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi sipas përcaktimeve të nenit 16 të këtij vendimi;
3. "çlirim për qarkullim të lirë" nënkupton procedurën doganore sipas legjislacionit doganor në fuqi, nëpërmjet së cilës mallrat joshqiptare të destinuara për tregun shqiptar ose për

përdorim apo konsum privat brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë marrin statusin doganor përkatës sipas këtij legjislacioni;

4. "degradim pyjor" nënkupton ndryshime strukturore të mbulesës pyjore që marrin formën e shndërrimit të pyjeve primare ose të pyjeve të rigjeneruara natyrshëm në pyje plantacionesh ose në toka të tjera të pyllëzuara, ose të shndërrimit të pyjeve primare në pyje të mbjella,;
5. "deklaratë e kujdesit të duhur" është deklarata e paraqitur nga operatori ose operatori pasues, në përputhje me këtë vendim, e cila përmban të paktën elementet minimale të përcaktuara në Aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
6. "deklaratë e thjeshtuar" është deklarata e paraqitur në rastet e lejuara nga ky vendim, e cila përmban të paktën elementet minimale të përcaktuara në Aneksin 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.";
7. "dërgesë" nënkupton një dërgesë të produkteve të drurit;
8. "import" nënkupton hyrjen fizike ose futjen e produkteve të drurit nga çdo pjesë e territorit gjeografik të një vendi partner për t'i sjellë ato në Republikën e Shqipërisë;
9. "eksport" nënkupton procedurën doganore sipas legjislacionit doganor në fuqi, që lejon daljen e mallrave shqiptare nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;
10. "gjeolokacion" nënkupton vendndodhjen gjeografike të parcelës përkatëse të tokës, e paraqitur në përputhje me kërkesat minimale të Aneksit 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përshkruar me koordinata të gjerësisë dhe gjatësisë gjeografike me së paku gjashtë shifra dhjetore; për parcelat me sipërfaqe mbi 4 ha, gjeolokacioni jepet me poligone që përshkruajnë perimetrin e parcelës;
11. "hedhje në treg" nënkupton vënien për herë të parë në dispozicion në treg të një malli përkatës ose produkti përkatës;
12. "legjislacioni në fuqi i vendit të prodhimit" nënkupton legjislacionin e zbatueshëm në vendin e prodhimit lidhur me statusin juridik të zonës së prodhimit, duke përfshirë të drejtat e përdorimit të tokës, mbrojtjen e mjedisit, rregullat për pyjet, menaxhimin e pyjeve dhe ruajtjen e biodiversitetit kur lidhen drejtpërdrejt me shfrytëzimin e drurit, të drejtat e palëve të treta, të drejtat e punës, të drejtat e njeriut të mbrojtura nga e drejta ndërkombëtare, parimin e pëlqimit të lirë, paraprak dhe të informuar, kur është i zbatueshëm, si dhe rregullat tatimore, kundër korrupsionit, tregtare dhe doganore;
13. "legjislacioni në fuqi i vendit të shfrytëzimit" nënkupton legjislacionin e zbatueshëm në vendin e shfrytëzimit për të drejtat e shfrytëzimit, pagesat për të drejtat e shfrytëzimit dhe lëndën drusore, rregullat mjedisore dhe pyjore, menaxhimin e pyjeve, ruajtjen e biodiversitetit kur lidhet drejtpërdrejt me shfrytëzimin e drurit, të drejtat e palëve të treta, si dhe rregullat tregtare dhe doganore.
14. "lëndë drusore e prodhuar ligjërisht" nënkupton produktet e lëndës drusore të prodhuara nga lënda drusore vendase që është shfrytëzuar ligjërisht ose nga lënda drusore që është importuar ligjërisht në një vend partner në përputhje me legjislacionin kombëtar të përcaktuar nga ai vend partner, siç parashikohet në Marrëveshjen e Partneritetit, sipas Rregullores (KE) Nr. 2173/2005 (FLEGT);

15. "licencë FLEGT" është dokumenti me format standard, i mbrojtur nga falsifikimi, i pacenueshëm dhe i verifikueshëm, i cili lidhet me një dërgesë ose me një pjesëmarrës në treg dhe që provon se kjo dërgesë është në përputhje me kërkesat e skemës së licencimit FLEGT, i lëshuar dhe i vlefësuar rregullisht nga autoriteti licencues i vendit partner. Sistemet për lëshimin, regjistrimin dhe komunikimin e licencave mund të jenë sipas rastit në letër ose elektronike;
16. "mallra përkatëse" janë gjedhi, kakaoja, kafeja, vaji i palmës, goma, soja dhe druri;
17. "monitorim nga palë e tretë" nënkupton një sistem nëpërmjet të cilit një organizatë që është e pavarur nga autoritetet qeveritare të një vendi partner dhe nga sektori i tij pyjor dhe i drurit monitoron dhe raporton mbi funksionimin e skemës së licencimit FLEGT.
18. "operator" është çdo person fizik ose juridik që, në kuadër të një veprimtarie tregtare, hedh në treg ose eksporton mallra përkatëse ose produkte përkatëse, me përjashtim të operatorit pasues. Për qëllime të këtij vendimi, operator konsiderohet edhe operatori parësor mikro ose i vogël kur ky është person fizik ose mikrondërmarrje, ose, ndërmarrje e vogël, sipas legjislacionit përkatës në fuqi për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, e vendosur në një vend të klasifikuar me rrezik të ulët nga Komisioni Evropian, dhe hedh në treg ose eksporton produkte përkatëse që vetë i ka rritur, /vjelurapo shfrytëzuar, përftuar ose mbarështuar në parcela përkatëse të tokës ose, për gjedhin, në njësi mbarështimi të vendosura në atë vend;
19. "operator pasues" është çdo person fizik ose juridik që, në kuadër të një veprimtarie tregtare, hedh në treg ose eksporton produkte përkatëse të prodhuara duke përdorur produkte përkatëse të mbuluara nga një deklaratë e kujdesit të duhur ose nga një deklaratë e thjeshtuar;
20. "pa lidhje me shpyllëzimin" është statusi i mallrave përkatëse ose produkteve përkatëse që janë prodhuar në toka që nuk kanë qenë subjekt i shpyllëzimit pas datës 31 dhjetor 2020 dhe, në rastin e drurit dhe produkteve të prodhuara duke përdorur dru, druri është korrur/vjelur/shfrytëzuar pa shkaktuar degradim pyjor pas kësaj date;
21. "parcela përkatëse e tokës" nënkupton tokën brenda një prone të vetme të pasurive të paluajtshme, sipas njohjes nga ligji i vendit të prodhimit, e cila paraqet kushte mjaftueshëm homogjene për të lejuar vlerësimin e nivelit të agreguar të rrezikut të shpyllëzimit dhe degradimit pyjor të lidhur me mallrat përkatëse të prodhuara në atë tokë;
22. "përdorim bujqësor" nënkupton përdorimin e tokës për qëllime bujqësore, përfshirë plantacionet bujqësore dhe sipërfaqet bujqësore të lëna djerrë, ose për mbarështimin e bagëtive;
23. "pjesëmarrës në treg" është çdo operator/subjekt, privat ose publik, i përfshirë në pylltari ose në transformimin ose tregtimin e produkteve të drurit;
24. "plantacion bujqësor" nënkupton çdo sipërfaqe toke me grumbuj me drurë në sistemet e prodhimi bujqësor, të tilla si parcelat me drurë frutorë, ullishtat dhe sistemet e tilla ku kulturat bujqësore rriten nën kurorat e drurëve, përfshi plantacionet e mallrave përkatëse, me përjashtim të drurit dhe nuk bën pjesë në fondin pyjor;

25. "prodhuar" nënkupton rritur, korrur, përftuar ose mbarështuar në parcela përkatëse të tokës ose, për gjedhin, në njësi mbarështimi, ku me këtë të fundit nënkuptohet çdo ambient ose vend ku mbahen bagëtitë, përkohësisht ose në mënyrë të përhershme;
26. "produkte druri", për qëllime të Kreut VIII të këtij vendimi, janë produktet e përcaktuara në Aneksin 1/1 dhe 1/2 të këtij vendimi, ndaj të cilave zbatohet skema e licencimit FLEGT, dhe të cilat, kur importohen në Republikën e Shqipërisë, nuk mund të kualifikohen si "mallra me natyrë jotregtare" sipas legjislacionit doganor në fuqi;
27. "produkte në mospërputhje" janë mallrat përkatëse ose produktet përkatëse që nuk përmbushin kërkesat e këtij vendimi;
28. "produkte përkatëse që dalin nga tregu" nënkupton produktet përkatëse të vendosura nën procedurën doganore të eksportit.
29. "produkte përkatëse që hyjnë në treg" nënkupton produktet përkatëse nga jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, të vendosura nën procedurën doganore të çlirimit për qarkullim të lirë, të destinuara të hidhen në treg në Republikën e Shqipërisë dhe jo për përdorim ose konsum privat;
30. "produkte përkatëse" janë produktet e listuara në Aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, të cilat përmbajnë, janë ushqyer me ose janë prodhuar duke përdorur mallra përkatëse;
31. "pyll" nënkupton tokë me sipërfaqe më të madhe se 0.5 ha, me pemë më të larta se 5 metra dhe me shkallë mbulimi mbi 10 për qind, ose me drurë që mund t'i arrijnë këto pragje në kushtet natyrore të vendndodhjes, duke përjashtuar tokën që përdoret kryesisht për qëllime bujqësore ose urbane;
32. "pyll i mbjellë" nënkupton pyll të përbërë kryesisht nga pemë të krijuara përmes mbjelljes ose farëzimit të qëllimshëm, me kusht që pemët e mbjella ose të farëzuara të përbëjnë më shumë se 50 për qind të fondit pyjor në maturim; ai përfshin edhe cungishtet nga pemë që fillimisht janë mbjellë ose farëzuar;
33. "pyll i rigjeneruar natyrshëm" nënkupton pyll të përbërë kryesisht nga pemë të krijuara përmes rigjenerimit natyror, duke përfshirë pyjet për të cilat nuk mund të dallohet nëse janë mbjellë apo janë rigjeneruar natyrshëm, pyjet e përziera ku mbizotërojnë pemët e rigjeneruara natyrshëm, cungishtet që rrjedhin nga pemë të krijuara fillimisht përmes rigjenerimit natyror dhe pemët e rigjeneruara natyrshëm të llojeve të introduktuara;
34. "pyll plantacion" nënkupton një pyll të mbjellë që menaxhohet intensivisht dhe që, në momentin e mbjelljes dhe në maturimin e ngastrës, përmbush njëkohësisht kriteret e një ose dy llojeve, moshës së njëtrajtshme dhe shpërndarjes së rregullt; ai përfshin plantacionet me rotacion të shkurtër për dru, fibër dhe energji dhe përjashton pyjet e mbjella për mbrojtje ose restaurim të ekosistemit, si dhe pyjet që në maturim i ngjajnë pyjeve të rigjeneruara natyrshëm;
35. "pyll primar" nënkupton pyll të rigjeneruar natyrshëm me lloje vendëse drurësh, ku nuk ka tregues qartësisht të dukshëm të veprimtarisë njerëzore dhe proceset ekologjike nuk janë shqetësuar në mënyrë të konsiderueshme;
36. "rrezik i papërfillshëm" nënkupton nivelin e rrezikut në të cilin, mbi bazën e vlerësimit të plotë të informacionit specifik të produktit dhe informacionit të përgjithshëm, si dhe, kur

është e nevojshme, pas zbatimit të masave të përshtatshme të zbutjes, nuk ekziston shkak shqetësimi se malli përkatës ose produkti përkatës nuk është në përputhje me kërkesat e këtij vendimi;

37. "shfrytëzim jo ligjor" nënkupton shfrytëzimin në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të vendit të shfrytëzimit;
38. "shfrytëzim ligjor" nënkupton shfrytëzimin në përputhje me legjislacionin në fuqi të vendit të shfrytëzimit;
39. "shpyllëzim" nënkupton shndërrimin e pyllit në përdorim bujqësor, pavarësisht nëse është shkaktuar nga veprimtaria njerëzore apo jo;
40. "shqetësim i arsyetuar" nënkupton një pretendim të arsyetuar, të mbështetur në informacion objektiv dhe të verifikueshëm, për një mospërputhje të mundshme, që mund të kërkojë ndërhyrjen e autoritetit kompetent;
41. "skema e licencimit FLEGT" është regjimi i lëshimit të licencave për produktet e drurit që eksportohen nga një vend partner dhe importohen në Republikën e Shqipërisë dhe zbatimi përkatës, në veçanti në kontrollet kufitare;
42. "tokë tjetër e pyllëzuar" nënkupton tokë që nuk klasifikohet si pyll, me sipërfaqe më të madhe se 0.5 ha, me pemë më të larta se 5 metra dhe me shkallë mbulimi nga 5 për qind deri në 10 për qind, ose me pemë që mund t'i arrijnë këto pragje në kushtet natyrore të vendndodhjes, ose me mbulesë të kombinuar të shkurreve, ferrave dhe pemëve mbi 10 për qind, duke përjashtuar tokën që përdoret kryesisht për qëllime bujqësore ose urbane;
43. "tregtar" nënkupton çdo person fizik ose juridik në zinxhirin e furnizimit, i ndryshëm nga operatori dhe operatori pasues, që, në kuadër të një veprimtarie tregtare, vë në dispozicion në treg produkte përkatëse;
44. "vend i origjinës" nënkupton vendin ose territorin ku një mall përkatës ose produkt përkatës është përftuar tërësisht ose, kur prodhimi përfshin më shumë se një vend ose territor, vendin ose territorin ku i është nënshtruar përpunimit ose transformimit të fundit thelbësor;
45. "vend partner" është shteti ose organizata rajonale partnere që hyn në një Marrëveshje Partneriteti, siç renditen në Aneksin I të Rregullores (KE) Nr. 2173/2005 (FLEGT), përfshirë edhe ndryshime eventuale të këtij Aneksi në të ardhmen.
46. "vendi i prodhimit" nënkupton vendin ose territorin ku është prodhuar malli përkatës ose produkti përkatës i përdorur në prodhimin, ose i përmbajtur në, produktin përkatës;
47. "vendi i shfrytëzimit" nënkupton vendin ose territorin ku është shfrytëzuar lënda drusore;
48. "vënie në dispozicion në treg" nënkupton çdo furnizim të një produkti përkatës për shpërndarje, konsum ose përdorim në treg, në kuadër të një veprimtarie tregtare, kundrejt pagesës ose pa pagesë;

Neni 4
Kufizimet për hedhjen në treg, dhe eksportin

1. Mallrat përkatëse dhe produktet përkatëse nuk mund të hidhen në treg, të vihen në dispozicion në treg ose të eksportohen, përveçse kur plotësohen njëkohësisht këto kushte:
   a) janë pa lidhje me shpyllëzimin;
   b) janë prodhuar në përputhje me legjislacionin përkatës të vendit të prodhimit;
   c) mbulohen nga një deklaratë e kujdesit të duhur, e përgatitur me përmbajtjen minimale sipas Anekstit 2 të këtij vendimi, ose, sipas rastit, nga një deklaratë e thjeshtuar me përmbajtjen minimale sipas Aneksit 3 të këtij vendimi.
2. Mënyra e mbledhjes, verifikimit dhe ruajtjes së informacionit, dokumentacionit dhe të të dhënave që provojnë përmbushjen e kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni rregullohet sipas dispozitave të këtij vendimi.

KREU II
MBI DETYRIMET E OPERATORËVE, OPERATORËVE PASUES DHE TREGTARËVE PËR TREGËTIMIN DHE EKSPORTIN E PRODUKTEVE QË LIDHEN ME SHPYLLËZIMIN DHE DEGRADIMIN E PYJEVE (EUDR)

Neni 5
Detyrimet e operatorëve

1. Operatori ushtron kujdesin e duhur përpara hedhjes në treg ose eksportit të mallrave përkatëse dhe produkteve përkatëse, me qëllim që të provojë se ato janë pa lidhje me shpyllëzimin, janë prodhuar në përputhje me legjislacionin përkatës të vendit të prodhimit dhe plotësojnë kërkesat e këtij vendimi.
2. Operatori nuk i hedh në treg dhe nuk i eksporton mallrat përkatëse ose produktet përkatëse pa paraqitur më parë deklaratën e kujdesit të duhur. Kur, mbi bazën e kujdesit të duhur të ushtruar, operatori arrin në përfundimin se mallrat përkatëse ose produktet përkatëse janë në përputhje me këtë vendim, ai, përpara hedhjes në treg ose eksportit, vë në dispozicion të autoritetit kompetent deklaratën e kujdesit të duhur me përmbajtjen sipas Aneksit 2 të këtij vendimi, nëpërmjet portalit elektronik të deklarimeve. Deklarata përmban edhe një deklarim të operatorit se ka ushtruar kujdesin e duhur dhe se nuk është konstatuar asnjë rrezik ose është konstatuar vetëm rrezik i papërfillshëm.
3. Me vënien në dispozicion të deklaratës së kujdesit të duhur ose, sipas rastit, me paraqitjen e deklaratës së thjeshtuar sipas Aneksit 3 të këtij vendimi, operatori merr përgjegjësinë për përputhshmërinë e mallit përkatës ose produktit përkatës me kërkesat e këtij vendimi. Operatori mban regjistrin e deklaratave të paraqitura për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh nga data e paraqitjes së tyre në portalin elektronik të deklarimeve.

4. Operatori nuk i hedh në treg dhe nuk i eksporton mallrat përkatëse ose produktet përkatëse kur:
   a) ato janë në mospërputhje;
   b) ushtrimi i kujdesit të duhur ka zbuluar një rrezik jo të papërfillshëm se ato janë në mospërputhje; ose
   c) operatori nuk ka qenë në gjendje të përmbushë detyrimet e përcaktuara në këtë vendim.
5. Operatori që siguron ose vihet në dijeni për informacion të ri përkatës, përfshirë një shqetësim të arsyetuar, që tregon se një mall përkatës ose produkt përkatës që ai e ka hedhur në treg është në rrezik mospërputhjeje me këtë vendim, njofton menjëherë autoritetin kompetent, si dhe operatorët pasues dhe tregtarët të cilëve ua ka furnizuar produktin. Në rast eksporti, operatori njofton autoritetin kompetent nga i cili kryhet eksporti.
6. Operatori ofron të gjithë ndihmën e nevojshme për institucionet dhe strukturat përgjegjëse si dhe autoritetin kompetent për të lehtësuar kryerjen e kontrolleve, përfshirë lejimin e hyrjes në mjediset përkatëse dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit dhe regjistrave.
7. Operatori u komunikon operatorëve pasues dhe tregtarëve më tej në zinxhirin e furnizimit numrat referues të deklaratave të kujdesit të duhur ose, sipas rastit, identifikuesit e deklaratave që lidhen me mallrat përkatëse ose produktet përkatëse të hedhura në treg ose të eksportuara prej tij.

Neni 6

Regjimi i thjeshtuar për operatorët parësorë, mikro ose të vegjël

1. Për operatorët parësorë, mikro ose të vegjël nuk zbatohen detyrimet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 5, në fjalinë e dytë të pikës 3 të nenit 5 dhe në shkronjën "c" të pikës 4 të nenit 5 të këtij vendimi.
2. Operatori parësor, mikro ose i vogël paraqet përpara hedhjes në treg ose eksportit të mallrave përkatëse ose produkteve përkatëse, një herë të vetme një deklaratë të thjeshtuar sipas Aneksit 3 të këtij vendimi, nëpërmjet portalit modulit elektronik të deklarimeve. Pas paraqitjes së saj, këtij operatori i caktohet një identifikues deklarate.
3. Operatori parësor, mikro ose i vogël paraqet në deklaratën e thjeshtuar të dhënat e përcaktuara në Aneksin 3 të këtij vendimi dhe i përditëson ato sa herë që ndodhin ndryshime të rëndësishme në informacionin e dhënë më parë.
4. Kur të gjitha të dhënat e kërkuara në aneksin përkatës gjenden në një bazë të dhënash shtetërore ose në një sistem tjetër informativ të ngritur sipas legjislacionit në fuqi, operatori parësor, mikro ose i vogël nuk është i detyruar të riparaqesë deklaratën e thjeshtuar, me kusht që këto të dhëna të bëhen të disponueshme për të në portalin elektronik të deklarimeve. Në çdo rast, hedhja në treg ose eksporti lejohen vetëm pasi operatorit t'i jetë caktuar identifikuesi i deklaratës.

5. Për operatorin parësor mikro ose të vogël, gjeolokacioni i kërkuar sipas Aneksit 4 të këtij vendimi, mund të zëvendësohet me adresën postare të të gjitha parcelave të tokës ose, sipas rastit, me adresën postare të njësisë së prodhimit ose të njësisë së mbarështimit nga e cila janë prodhuar mallrat përkatëse që përmban ose ka përdorur produkti përkatës.

Neni 7
Detyrimet e operatorëve pasues dhe tregtarëve

1. Operatori pasues dhe tregtari hedhin në treg, vënë në dispozicion në treg ose eksportojnë produkte përkatëse vetëm nëse zotërojnë informacionin e kërkuar sipas këtij neni.
2. Operatorët pasues që nuk kualifikohen si ndërmarrje mikro, të vogla ose të mesme dhe tregtarët që nuk kualifikohen si ndërmarrje mikro, të vogla ose të mesme regjistrohen paraprakisht në portalin elektronik të deklarimeve përpara se të hedhin në treg, të vënë në dispozicion në treg ose të eksportojnë produkte përkatëse.
3. Operatori pasues dhe tregtari mbledhin dhe ruajnë, për produktet përkatëse që synojnë të hedhin në treg, të vënë në dispozicion në treg ose të eksportojnë, të paktën këto të dhëna:
   a) emrin, emrin tregtar ose markën e regjistruar, adresën postare, adresën elektronike dhe, kur ekziston, faqen e internetit të operatorëve, operatorëve pasues ose tregtarëve që ua kanë furnizuar produktet përkatëse, si dhe, kur furnizuesi është operator, numrat referues të deklaratave të kujdesit të duhur ose identifikuesit e deklaratave që lidhen me ato produkte;
   b) emrin, emrin tregtar ose markën e regjistruar, adresën postare, adresën elektronike dhe, kur ekziston, faqen e internetit të operatorëve pasues ose tregtarëve të cilëve ua kanë furnizuar produktet përkatëse.
4. Operatori pasues dhe tregtari ruajnë informacionin e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni për të paktën 5 (pesë) vjet nga data e hedhjes në treg, vënies në dispozicion në treg ose eksportit dhe ia vënë atë në dispozicion autoritetit kompetent me kërkesë të këtij të fundit.
5. Operatori pasues dhe tregtari që sigurojnë ose vihen në dijeni për informacion të ri përkatës, përfshirë shqetësime të arsyetuara, që tregojnë se një produkt përkatës i hedhur në treg ose i vënë në dispozicion në treg prej tyre është në rrezik mospërputhjeje me këtë vendim, njoftojnë menjëherë autoritetin kompetent, si dhe operatorët pasues dhe tregtarët të cilëve ua kanë furnizuar produktin. Në rast eksporti, operatori pasues njofton autoritetin kompetent nga i cili kryhet eksporti.
6. Kur operatorët pasues që nuk janë ndërmarrje mikro, të vogla ose të mesme dhe tregtarët që nuk janë ndërmarrje mikro, të vogla ose të mesme sigurojnë ose vihen në dijeni, përpara hedhjes në treg, vënies në dispozicion në treg ose eksportit, për informacion përkatës që tregon se produkti përkatës mund të mos jetë në përputhje me këtë vendim, ata njoftojnë menjëherë autoritetin kompetent dhe verifikojnë se është ushtruar kujdesi i duhur dhe se nuk ekziston asnjë rrezik ose ekziston vetëm rrezik i papërfillshëm. Produkti përkatës nuk mund të hidhet në treg, të vihet në dispozicion në treg ose të eksportohet nëse verifikimi nuk provon mungesën e rrezikut ose ekzistencën vetëm të rrezikut të papërfillshëm.

7. Operatori pasues dhe tregtari ofrojnë të gjithë ndihmën e nevojshme për institucionet përgjegjëse dhe autoritetin kompetent për të lehtësuar kryerjen e kontrolleve, përfshirë lejimin e hyrjes në mjediset përkatëse dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit dhe regjistrave.

Neni 8
Përfaqësuesi i autorizuar

1. Operatori mund të autorizojë me mandat një përfaqësues të autorizuar për të paraqitur në emër të tij deklaratën e kujdesit të duhur ose deklaratën e thjeshtuar. Në çdo rast, operatori ruan përgjegjësinë për përputhshmërinë e mallit përkatës ose produktit përkatës me kërkesat e këtij vendimi.
2. Përfaqësuesi i autorizuar i vë në dispozicion autoritetit kompetent, me kërkesë të tij, kopjen e mandatit në gjuhën shqipe ose të shoqëruar me përkthim zyrtar në gjuhën shqipe.
3. Operatori që është person fizik ose mikro-ndërmarrje mund të autorizojë operatorin pasues ose tregtarin vijues në zinxhirin e furnizimit, me kusht që ky i fundit të mos jetë person fizik ose mikro-ndërmarrje, të veprojë si përfaqësues i autorizuar. Në këtë rast, operatori pasues ose tregtari nuk mund të hedhë në treg, të vërë në dispozicion në treg ose të eksportojë produktin përkatës pa paraqitur deklaratën e kujdesit të duhur ose, sipas rastit, deklaratën e thjeshtuar në emër të operatorit. Edhe në këtë rast, operatori fillestar ruan përgjegjësinë për përputhshmërinë e produktit përkatës me këtë vendim.

Neni 9
Hedhja në treg nga persona të vendosur jashtë Republikës së Shqipërisë

Kur një person fizik ose juridik i vendosur jashtë Republikës së Shqipërisë hedh në treg produkte përkatëse, personi i parë fizik ose juridik i vendosur në Republikën e Shqipërisë që i vë ato në dispozicion në treg, konsiderohet operator për qëllime të këtij vendimi dhe mban detyrimet përkatëse.

Neni 10
Kujdesi i duhur

1. Përpara hedhjes në treg ose eksportit të mallrave përkatëse ose produkteve përkatëse, operatori ushtron kujdesin e duhur për të gjitha mallrat përkatëse dhe produktet përkatëse që mbulohen nga veprimtaria e tij.
2. Kujdesi i duhur përfshin:
   a) mbledhjen e informacionit, të të dhënave dhe të dokumenteve të nevojshme për përmbushjen e kërkesave të nenit 11 të këtij vendimi;
   b) masat për vlerësimin e rrezikut sipas nenit 12 të këtij vendimi, dhe
   c) masat për zbutjen e rrezikut sipas nenit 13 të këtij vendimi.

Neni 11
Kërkesat e informacionit

1. Operatori mbledh informacionin, dokumentet dhe të dhënat që provojnë se mallrat përkatëse ose produktet përkatëse janë në përputhje me këtë vendim. Për këtë qëllim, operatori mbledh, organizon dhe ruan, për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh nga data e hedhjes në treg ose e eksportit, të paktën informacionin e mëposhtëm, të shoqëruar me provat përkatëse, për secilin mall përkatës ose produkt përkatës:
   a) përshkrimin e mallit përkatës ose produktit përkatës, duke përfshirë emërtimin tregtar dhe llojin e produktit, si dhe, për produktet përkatëse që përmbajnë dru ose janë prodhuar duke përdorur dru, emrin e zakonshëm të llojit dhe emrin e plotë shkencor të tij; përshkrimi përfshin edhe listën e mallrave përkatëse ose të produkteve përkatëse të përfshira ose të përdorura në prodhimin e produktit;
   b) sasinë e mallit përkatës ose të produktit përkatës; për produktet përkatëse që hyjnë në treg ose dalin nga tregu, sasia shprehet në kilogramë peshë neto dhe, kur është rasti, edhe në njësinë plotësuese të parashikuar në nomenklaturën e kombinuar të mallrave për kodin e deklaruar; në rastet e tjera, sasia shprehet në peshë neto ose, sipas rastit, në vëllim ose në numër njësish;
   c) vendin e prodhimit dhe, kur është e nevojshme, pjesët përkatëse të tij;
   ç) gjeolokacionin e të gjitha parcelave të tokës ku janë prodhuar mallrat përkatëse që përmban ose ka përdorur produkti përkatës, paraqitur në përputhje me kërkesat minimale të Aneksit 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe datën ose intervalin kohor të prodhimit; kur produkti përkatës përmban ose është prodhuar me mallra përkatëse të prodhuara në parcela të ndryshme, përfshihet gjeolokacioni i të gjitha parcelave; çdo shpyllëzim ose degradim pyjor i ndodhur në këto parcela pas datës përkatëse e bën në mospërputhje mallin përkatës ose produktin përkatës që buron prej tyre; për produktet përkatëse që përmbajnë gjedhë ose janë ushqyer me produkte përkatëse, gjeolokacioni i referohet të gjitha njësive të mbarështimit ku janë mbajtur gjedhët; për produktet e tjera përkatëse, gjeolokacioni i referohet parcelave të tokës;
   d) emrin, adresën postare dhe adresën elektronike të çdo subjekti ekonomik ose personi nga i cili operatori është furnizuar me mallin përkatës ose produktin përkatës;
   dh) emrin, adresën postare dhe adresën elektronike të çdo subjekti ekonomik, operatori pasues ose tregtari të cilit operatori ia ka furnizuar mallin përkatës ose produktin përkatës;
   e) informacion të mjaftueshëm, përfundimtar dhe të verifikueshëm që provon se mallrat përkatëse ose produktet përkatëse janë pa lidhje me shpyllëzimin;
   ë) informacion të mjaftueshëm, përfundimtar dhe të verifikueshëm që provon se mallrat përkatëse janë prodhuar në përputhje me legjislacionin përkatës të vendit të prodhimit, duke përfshirë çdo akt ose marrëveshje që jep të drejtën e përdorimit të zonës për qëllime të prodhimit të mallit përkatës.

2. Operatori i vë në dispozicion autoritetit kompetent, me kërkesë të tij, informacionin, dokumentet dhe të dhënat e mbledhura sipas këtij neni.

Neni 12
Vlerësimi i rrezikut

1. Operatori verifikon dhe analizon informacionin e mbledhur sipas nenit 11 të këtij vendimi, si dhe çdo dokumentacion tjetër përkatës. Mbi bazën e këtij informacioni dhe dokumentacioni, operatori kryen vlerësimin e rrezikut për të përcaktuar nëse ekziston rrezik që mallrat përkatëse ose produktet përkatëse që synohen të hidhen në treg ose të eksportohen të jenë në mospërputhje. Operatori nuk i hedh në treg dhe nuk i eksporton këto mallra ose produkte, përveçse kur vlerësimi tregon se nuk ekziston asnjë rrezik ose ekziston vetëm rrezik i papërfillshëm.
2. Vlerësimi i rrezikut merr në konsideratë, në veçanti, këto kritere:
   a) klasifikimin e nivelit të rrezikut për vendin e prodhimit ose për pjesët përkatëse të tij, sipas akteve të zbatueshme për këtë vendim;
   b) praninë e pyjeve në vendin e prodhimit ose në pjesët përkatëse të tij;
   c) praninë e popujve indigjenë ose komuniteteve tradicionale në vendin e prodhimit ose në pjesët përkatëse të tij;
   ç) konsultimin dhe bashkëpunimin në mirëbesim me popujt indigjenë ose komunitetet tradicionale në vendin e prodhimit ose në pjesët përkatëse të tij;
   d) ekzistencën e pretendimeve të arsyetuara, të mbështetura në informacion objektiv dhe të verifikueshëm, lidhur me përdorimin ose pronësinë e zonës së përdorur për prodhimin e mallit përkatës;
   dh) përhapjen e shpyllëzimit ose degradimit pyjor në vendin e prodhimit ose në pjesët përkatëse të tij;
   e) burimin, besueshmërinë, vlefshmërinë dhe lidhjen me dokumentacionin tjetër të informacionit të mbledhur sipas nenit 11;
   ë) shqetësimet që lidhen me vendin e prodhimit ose me pjesët përkatëse të tij, të tilla si niveli i korrupsionit, përhapja e falsifikimit të dokumenteve ose të dhënave, mungesa e zbatimit të ligjit, shkeljet e të drejtave të njeriut, konfliktet e armatosura ose prania e sanksioneve ndërkombëtare;
   f) kompleksitetin e zinxhirit të furnizimit dhe fazën e përpunimit të produktit, veçanërisht vështirësitë për të lidhur produktin përkatës me parcelën e tokës ku është prodhuar malli përkatës;
   g) rrezikun e anashkalimit të këtij vendimi ose të përzierjes me produkte me origjinë të panjohur ose me origjinë nga vende ose pjesë territoresh me rrezik të lartë ose standard;
   gj) shqetësimet e arsyetuara dhe historikun e mospërputhjes së operatorëve ose tregtarëve përgjatë zinxhirit përkatës të furnizimit;
   h) çdo informacion tjetër që tregon rrezik mospërputhje;

i) informacionin plotësues mbi përputhshmërinë, përfshirë atë të dhënë nga skema certifikimi ose verifikimi nga palë të treta, për sa kohë që ky informacion përmbush kërkesat e nenit 11 të këtij vendimi.

3. Produktet e drurit që mbulohen nga skema operative e licencimit FLEGT dhe shoqërohen me licencë të vlefshme FLEGT konsiderohen në përputhje me kërkesën për ligjshmërinë e prodhimit. Kjo konsiderohet në përputhje vetëm me legjislacionin përkatës të vendit të prodhimit dhe nuk e përjashton operatorin nga detyrimi për verifikimin e përmbushjes së kërkesave të tjera të këtij vendimi.
4. Operatori dokumenton dhe rishikon vlerësimin e rrezikut të paktën një herë në vit dhe ia vë atë në dispozicion autoritetit kompetent, me kërkesë të tij. Operatori duhet të jetë në gjendje të provojë mënyrën se si informacioni i mbledhur është kontrolluar kundrejt kritereve të vlerësimit të rrezikut dhe mënyrën se si është përcaktuar shkalla e rrezikut.

Neni 13
Masat për zbutjen e rrezikut

1. Përveç rasteve kur vlerësimi i rrezikut i kryer sipas nenit 12 të këtij vendimi tregon se nuk ekziston asnjë rrezik ose ekziston vetëm rrezik i papërfillshëm, operatori, përpara hedhjes në treg ose eksportit, merr masa dhe zbaton procedura të përshtatshme për zbutjen e rrezikut, me qëllim arritjen e mungesës së rrezikut ose të ekzistencës vetëm të rrezikut të papërfillshëm. Këto masa dhe procedura mund të përfshijnë, ndër të tjera:
   a) kërkimin e informacionit, të të dhënave ose të dokumenteve shtesë;
   b) kryerjen e verifikimeve, sondazheve ose auditimeve të pavarura;
   c) marrjen e masave të tjera që lidhen me kërkesat e informacionit të përcaktuara në nenin 11 të këtij vendimi. Masat mund të përfshijnë edhe mbështetjen e furnizuesve, në veçanti të prodhuesve të vegjël, për përputhshmërinë me këtë vendim nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve dhe investimeve.
2. Operatori ndjek politika, kontrolle dhe procedura të përshtatshme e proporcionale për të zbutur dhe administruar në mënyrë efektive rreziqet e mospërputhjes të identifikuara për mallrat përkatëse ose produktet përkatëse. Këto politika, kontrolle dhe procedura përfshijnë:
   a) praktika model për administrimin e rrezikut, raportimin, mbajtjen e regjistrave, kontrollin e brendshëm dhe administrimin e përputhshmërisë, përfshirë caktimin e një punonjësi përgjegjës për përputhshmërinë në nivel drejtues për operatorët që nuk janë ndërmarrje mikro, të vogla ose të mesme;
   b) një funksion të pavarur auditimi për të kontrolluar politikat, kontrollet dhe procedurat e brendshme të parashikuara në shkronjën "a" për të gjithë operatorët që nuk janë ndërmarrje mikro, të vogla ose të mesme.
3. Vendimet për procedurat dhe masat e zbutjes së rrezikut dokumentohen, rishikohen të paktën një herë në vit dhe i vihen në dispozicion autoritetit kompetent me kërkesë të tij. Operatori duhet të jetë në gjendje të provojë mënyrën se si janë marrë vendimet për zbutjen e rrezikut.

Neni 14
Krijimi dhe mirëmbajtja e sistemit të kujdesit të duhur, raportimi dhe ruajtja e dokumentacionit

1. Për ushtrimin e kujdesit të duhur sipas nenit 10 të këtij vendimi, operatori krijon dhe mban të përditësuar një kuadër procedurash dhe masash që sigurojnë se mallrat përkatëse ose produktet përkatëse që ai hedh në treg ose eksporton janë në përputhje me këtë vendim. Ky kuadër përbën sistemin e kujdesit të duhur.
2. Operatori rishikon sistemin e kujdesit të duhur të paktën një herë në vit. Kur operatori vihet në dijeni për zhvillime të reja që mund të ndikojnë sistemin e kujdesit të duhur, ai e përditëson atë duke marrë parasysh këto zhvillime. Operatori ruan regjistrin e përditësimeve të kryera në sistemin e kujdesit të duhur për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh.
3. Operatorët që nuk janë ndërmarrje mikro, të vogla ose të mesme, person fizik ose mikro-ndërmarrje raportojnë publikisht, të paktën një herë në vit dhe në masën më të gjerë të mundshme, përfshirë përmes internetit, mbi sistemin e tyre të kujdesit të duhur dhe mbi hapat e ndërmarrë për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim. Kur mbi operatorin zbatohen edhe akte të tjera që kërkojnë raportim për kujdesin e duhur në zinxhirin e furnizimit, ky detyrim mund të përmbushet edhe nëpërmjet përfshirjes së informacionit të kërkuar në raportimin e kryer sipas atyre akteve, për aq sa ky informacion mbulon kërkesat e këtij vendimi.
4. Raportimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni përfshin të paktën:
   a) një përmbledhje të informacionit të përcaktuar në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 të nenit 11 të këtij vendimi;
   b) përfundimet e vlerësimit të rrezikut sipas nenit 12 dhe masat e marra sipas nenit 13, si dhe përshkrimin e informacionit dhe të provave të përdorura për vlerësimin e rrezikut;
   c) sipas rastit, përshkrimin e procesit të konsultimit me popujt indigjenë, komunitetet lokale, mbajtësit e të drejtave zakonore mbi tokën ose organizatat e shoqërisë civile të pranishme në zonën e prodhimit të mallrave përkatëse ose produkteve përkatëse.
5. Operatori ruan për të paktën 5 (pesë) vjet të gjithë dokumentacionin që lidhet me kujdesin e duhur, përfshirë regjistrat, masat dhe procedurat e zbatuara sipas këtij vendimi, dhe ia vë atë në dispozicion autoritetit kompetent me kërkesë të tij.

Neni 15
Kujdesi i duhur i thjeshtuar

1. Operatori, përpara hedhjes në treg ose eksportit të mallrave përkatëse ose produkteve përkatëse, nuk është i detyruar të kryejë vlerësimin e rrezikut dhe masat për zbutjen e rrezikut, sipas neneve 12 dhe 13 të këtij vendimi, vetëm kur, pas vlerësimit të kompleksitetit të zinxhirit të furnizimit, të rrezikut të shmangies së kërkesave të këtij vendimi dhe të rrezikut të përzierjes me mallra ose produkte me origjinë të panjohur ose

me origjinë nga vende apo pjesë vendesh të klasifikuara me rrezik standard ose të lartë, ka konstatuar se të gjitha mallrat përkatëse dhe produktet përkatëse janë prodhuar në vende ose pjesë vendesh të klasifikuara me rrezik të ulët, sipas mekanizmit të klasifikimit të zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë. Në këtë rast, operatori mban dhe vë në dispozicion të autoritetit kompetent, sipas kërkesës, dokumentacionin përkatës që provon se rreziku i shmangies së kërkesave të këtij vendimi ose i përzierjes me mallra ose produkte me origjinë të panjohur ose me origjinë nga vende apo pjesë vendesh me rrezik standard ose të lartë është i papërfillshëm.

2. Kur operatori merr ose vihet në dijeni për informacion të ri përkatës, përfshirë edhe informacion që rezulton nga vlerësimi i kryer sipas pikës 1 të këtij neni ose shqetësime të arsyetuara të paraqitura nga palë të treta, që tregon se ekziston rrezik që mallrat përkatëse ose produktet përkatëse të mos jenë në përputhje me këtë vendim ose që kërkesat e tij të jenë shmangur, operatori kryen menjëherë vlerësimin e rrezikut dhe zbaton masat për zbutjen e rrezikut, sipas neneve 12 dhe 13 të këtij vendimi, si dhe njofton menjëherë autoritetin kompetent.
3. Kur autoriteti kompetent merr ose vihet në dijeni për informacion që tregon se ekziston rrezik i shmangies së kërkesave të këtij vendimi, përfshirë rastet kur mallra përkatëse ose produkte përkatëse të prodhuara në vende ose pjesë vendesh me rrezik standard ose të lartë përpunohen më pas në një vend ose pjesë vendi me rrezik të ulët, prej nga hedhen në treg, vihen në dispozicion në treg ose eksportohen, ai merr menjëherë masat e nevojshme të kontrollit dhe, kur është e nevojshme, masa të ndërmjetme, në përputhje me këtë vendim.
4. Regjimi i kujdesit të duhur të thjeshtuar zbatohet vetëm kur klasifikimi i vendeve ose i pjesëve të vendeve sipas nivelit të rrezikut është i njohur dhe i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë. Deri në njohjen ose miratimin e listës së vendeve ose pjesëve të vendeve me rrezik të ulët, sipas dispozitave të këtij vendimi, operatori nuk mund të zbatojë regjimin e kujdesit të duhur të thjeshtuar dhe i nënshtrohet detyrimeve të plota të kujdesit të duhur.

KREU III
AUTORITETET DHE INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE KONTROLLET, MASAT DHE RAPORTIMI

Neni 16
Autoritetet dhe institucionet përgjegjëse

1. Autoriteti kompetent për koordinimin, kontrollet, masat dhe raportimin është ministria përgjeghjëse për pyjet, nëpërmjet një strukture të posaçme për këtë qëllim.
2. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi janë:

a. Ministria përgjegjëse për pyjet, si institucioni më i lartë politikbërës dhe rregullator

b. Agjencia Kombëtare e Pyjeve, si autoriteti kompetent qendror për zbatimin e këtij vendimi;

c. administrata doganore, e cila ushtron kompetencat e saj doganore për produktet përkatëse që hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë ose dalin prej tij dhe bashkëpunon me autoritetin kompetent për kontrollin, mbajtjen, pezullimin e zhdoganimit ose veprime të tjera të nevojshme, sipas legjislacionit doganor dhe këtij vendimi;

ç) Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, për fondin pyjor dhe veprimtaritë që ushtrohen në zonat e mbrojtura, sipas legjislacionit në fuqi;

d. strukturat inspektuese qendrore dhe vendore, sipas legjislacionit në fuqi për inspektimin dhe legjislacionit sektorial për pyjet;

dh) strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki;

1. institucionet e tjera publike që disponojnë, administrojnë ose shkëmbejnë të dhëna të nevojshme për origjinën, gjurmueshmërinë, shfrytëzimin, importin, eksportin, transportin, ligjshmërinë ose kontrollin e mallrave përkatëse dhe produkteve përkatëse.
3. Autoritetet dhe institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, bashkëpunojnë ngushtësisht me njëra-tjetrën për zbatimin e këtij vendimi. Autoriteti kompetent mund të kërkojë nga institucionet dhe strukturat e përmendura në pikën 1 të këtij neni kryerjen e verifikimeve, kontrolleve, inspektimeve ose dërgimin e të dhënave dhe dokumentacionit të nevojshëm për zbatimin e këtij vendimi, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Agjencia Kombëtare e Pyjeve, për ushtrimin e funksioneve të saj sipas këtij vendimi, mund të kërkojë informacion, dokumente, të dhëna nga çdo operator, operator pasues ose tregtar që bie në fushën e zbatimit të këtij vendimi.
5. Autoriteti kompetent ushtron funksionet e veta në mënyrë të pavarur, të pa-anshme dhe me burime të mjaftueshme njerëzore, teknike dhe financiare.
6. Çdo ndryshim në lidhje me emrat, adresat dhe të dhënat e kontaktit të autoritetit kompetent, i njoftohet pa vonesë Komisionit Europian.

Neni 17
Asistenca teknike, udhëzimet, shkëmbimi i informacionit, bashkëpunimi dhe raportimi

1. Në përputhje me kompetencat përkatëse, dhe pa cenuar detyrimin e operatorëve për të ushtruar kujdesin e duhur sipas këtij vendimi, autoriteti kompetent mund t'u ofrojë operatorëve, operatorëve pasues dhe tregtarëve asistencë teknike, asistencë tjetër dhe udhëzime, të cilat duhet të marrin parasysh situatën e personave fizikë, të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, përfshirë mikrondërmarrjet, për të lehtësuar përputhshmërinë me këtë vendim, duke përfshirë edhe rastet e konvertimit të dhënave nga sistemet përkatëse për identifikimin e gjeolokalizimit në sistemin e informacionit dhe aksesit në drejtësi sipas dispozitave përkatëse të këtij vendimi.
2. Në dhënien e asistencës, autoriteti kompetent duhet të marrë parasysh legjislacionin aktual dhe të ardhshëm të Bashkimit Evropian që përmban detyrime për kujdesin e duhur, për aq sa ky legjislacion është i zbatueshëm ose bëhet i detyrueshëm për Republikën e Shqipërisë.

3. Autoriteti kompetent lehtëson shkëmbimin dhe shpërndarjen e informacionit përkatës me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, në veçanti me qëllim që të ndihmojë operatorët, operatorët pasues dhe tregtarët në vlerësimin e rrezikut sipas nenit 12 të këtij vendimi, si dhe të promovojë përdorimin e praktikave më të mira në lidhje me këtë vendim.
4. Autoriteti kompetent, në përputhje me kompetencat përkatëse, monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe shkëmben informacion me homologët në Bashkimin Evropian mbi ndryshimet domethënëse në modelet e tregtisë së mallrave përkatëse dhe produkteve përkatëse, me qëllim identifikimin e rasteve kur ndryshime të tilla mund të çojnë në shmangien e kërkesave të këtij vendimi.
5. Asistenca teknike, asistenca tjetër dhe udhëzimet e dhëna nga autoriteti kompetent duhet të jepen në një mënyrë që nuk cenon pavarësinë, detyrimet ligjore ose përgjegjësitë e autoritetit kompetent në zbatimin e këtij vendimi.
6. Autoriteti kompetent bashkëpunon me autoritetet kompetente dhe autoritetet doganore të shteteve anëtare të BE, me Komisionin dhe, kur është e nevojshme, me autoritetet administrative të vendeve të treta, për të siguruar përputhshmërinë me këtë vendim, përfshirë zbatimin e auditimeve në terren.
7. Autoriteti kompetent krijon marrëveshje administrative me Komisionin lidhur me transmetimin e informacionit mbi hetimet dhe kryerjen e hetimeve. Autoriteti kompetent i komunikon gjithashtu Komisionit çdo gabim teknik domethënës të dokumentuar ose çdo ndërprerje domethënëse që lind nga sistemi i informacionit sipas nenit 33 të Rregullores (BE) 2023/1115.
8. Autoriteti kompetent shkëmben informacionin e nevojshëm për zbatimin e këtij vendimi, përfshirë përmes sistemit të informacionit sipas nenit 33 të Rregullores (BE) 2023/1115. Kjo përfshin dhënien e aksesit dhe shkëmbimin e informacionit për operatorët, operatorët pasues dhe tregtarët, përfshirë deklaratat e kujdesit të duhur dhe deklaratën e thjeshtuar për operatorët parësorë mikro ose të vegjël, si dhe për natyrën dhe rezultatet e kontrolleve të kryera, me autoritetet kompetente të shteteve të tjera anëtare, për të lehtësuar zbatimin e këtij vendimi.
9. Autoriteti kompetent njofton menjëherë autoritetet kompetente të shteteve të tjera anëtare dhe Komisionin kur zbulon ndonjë mospërputhshmëri të mundshme me këtë vendim dhe mangësi serioze që mund të prekin më shumë se një shtet anëtar. Në veçanti, autoriteti kompetent informon autoritetet kompetente të shteteve të tjera anëtare kur zbulon në treg një produkt përkatës që e konsideron produkt jo në përputhje, në mënyrë që të mundësohet tërheqja ose rikthimi i tij nga shitja në të gjitha shtetet anëtare. Me kërkesë të autoritetit kompetent të një shteti anëtar, Republika e Shqipërisë i jep atij informacionin e nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë me këtë vendim.
10. Deri më 30 prill të çdo viti, autoriteti kompetent vë në dispozicion të publikut dhe të Komisionit informacion mbi zbatimin e këtij vendimi gjatë vitit kalendarik të mëparshëm. Ky informacion përfshin:
    a) planet e kontrolleve dhe kriteret e rrezikut mbi të cilat janë bazuar ato plane;
    b) numrin dhe rezultatet e kontrolleve të kryera mbi operatorët, operatorët pasues dhe tregtarët, si dhe numrin total të operatorëve, operatorëve pasues jo-NVM (Ndërmarrje

të vogla dhe të mesme) dhe tregtarëve jo-NVM, përfshirë llojet e mospërputhshmërisë të identifikuara;

c) sasinë e produkteve përkatëse të kontrolluara në raport me sasinë totale të produkteve përkatëse të hedhura në treg ose të eksportuara, të mbuluara nga një deklaratë e kujdesit të duhur në sistemin e informacionit sipas nenit 33 të Rregullores (BE) 2023/1115; vendet e prodhimit; për produktet përkatëse që hyjnë ose dalin nga tregu, sasia shprehet në kilogramë të masës neto dhe, sipas rastit, në njësinë plotësuese të përcaktuar në Aneksin I të Rregullores (KEE) nr. 2658/87 kundrejt kodit të treguar të Sistemit të Harmonizuar, ose, në të gjitha rastet e tjera, sasia shprehet në masë neto ose, sipas rastit, vëllim ose numër njësish; një njësi plotësuese zbatohet kur ajo përcaktohet në mënyrë të njëtrajtshme për të gjitha nënndarjet e mundshme nën kodin e Sistemit të Harmonizuar të përmendur në deklaratën e kujdesit të duhur;

ç) në rastet e mospërputhshmërisë, veprimet korrigjuese të marra dhe sanksionet e vendosura;

d) përqindjen e kontrolleve të kryera me paralajmërim paraprak sipas nenit 18, pika 11, përdorimi i të cilit duhet të justifikohet nga autoriteti kompetent në raportet e kontrollit.

Neni 18
Detyrimi për kryerjen e kontrolleve dhe plani vjetor i kontrolleve

1. Autoriteti kompetent sigurohet që të kryhen kontrolle në përputhje me nenet 20 dhe 21 të këtij vendimi, për të verifikuar nëse operatorët, operatorët pasues dhe tregtarët përmbushin kërkesat e këtij vendimi dhe nëse mallrat përkatëse ose produktet përkatëse të hedhura në treg, të vëna në dispozicion në treg ose të eksportuara janë në përputhje me të. Kur kontrollet dhe/ose inspektimet janë kompetencë e administratës doganore dhe/ose e strukturave përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin, ato planifikohen dhe kryhen sipas legjislacionit përkatës në fuqi dhe dispozitave të këtij vendimi, në koordinim dhe bashkërendim me autoritetin kompetent.
2. Për qëllime të përcaktimit dhe kryerjes së kontrolleve të përmendura në pikën 1 të këtij neni, autoriteti kompetent harton dhe përditëson rregullisht metodologjinë e qasjes së bazuar në rrezik dhe kriteret kombëtare të rrezikut dhe ua përcjell strukturave përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin, për integrim në planet dhe programet të tyre, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. Kriteret e rrezikut përcaktohen mbi bazën e një analize të rrezikut të mospërputhshmërisë me këtë vendim, duke marrë parasysh, në veçanti, mallrat përkatëse, kompleksitetin dhe gjatësinë e zinxhirëve të furnizimit, përfshirë nëse përfshihet përzierja e produkteve përkatëse, fazën e përpunimit të produktit përkatës, nëse parcelat e tokës në fjalë janë ngjitur me pyje, caktimin e rrezikut për vendet ose pjesë të tyre sipas nenit sipas nenit 28 të këtij vendimi, me vëmendje të veçantë ndaj vendeve ose pjesëve të vendeve me rrezik të lartë, historikun e mospërputhshmërisë së operatorëve, operatorëve pasues ose tregtarëve, rrezikun e shmangies dhe çdo informacion tjetër përkatës. Analiza e rrezikut mbështetet në informacionin e parashikuar në nenet 11 dhe

12 të këtij vendimi dhe mund të mbështetet gjithashtu në informacionin e përmbajtur në sistemin e informacionit sipas nenit 33 Rregullores (BE) 2023/1115, në të dhëna monitorimi, profile rreziku nga organizata ndërkombëtare, shqetësime të arsyetuara të ngritura nga persona fizikë apo juridike, kriteret orientuese të rrezikut në nivel të BE të hartuara nga Komisioni Europian, përfundimet e mbledhjeve të grupeve të ekspertëve të Komisionit si dhe burime të tjera të besueshme e të verifikueshme.

3. Për qëllim të kryerjes së kontrolleve të përmendura në pikën 1 të këtij neni, autoriteti kompetent sigurohet që strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin hartojnë plane vjetore që përmbajnë të paktën sa vijon:
   a) kriteret kombëtare të rrezikut, të hartuara nga autoriteti kompetent sipas pikës 2 të këtij neni, të cilat i shërbejnë strukturave përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin për të përcaktuar kontrollet e nevojshme; këto kritere mbështeten në çdo kriter orientues rreziku të hartuar nga Komisioni Europian për aq sa është i zbatueshëm për Republikën e Shqipërisë, si dhe përfshijnë sistematikisht kritere rreziku në lidhje me vendet ose pjesë të tyre të klasifikuara me rrezik të lartë;
   b) përzgjedhjen e operatorëve, operatorëve pasues dhe tregtarëve që do të kontrollohen; kjo përzgjedhje bazohet në kriteret kombëtare të rrezikut të përmendura në shkronjën "a", duke përdorur, ndër të tjera, informacionin e përfshirë në sistemin e informacionit sipas nenit 33 Rregullores (BE) 2023/1115 dhe teknika elektronike të përpunimit të të dhënave; për secilin operator, operator pasues ose tregtar që do të kontrollohet, mund të përcaktohen deklarata të caktuara të kujdesit të duhur që do të kontrollohen.
4. Autoriteti kompetent sigurohet që rishikimi vjetor i planeve nga strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin, mbështetet sistematikisht në rezultatet e kontrolleve dhe përvojën e zbatimit të planeve të përmendura në pikën 3 të këtij neni, me qëllim përmirësimin e efektivitetit të tyre.
5. Autoriteti kompetent u vë në dispozicion autoriteteve homologe kompetente në vendet anëtare të BE dhe Komisionit të BE, planin e kontrollit të miratuar nga strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin dhe përditësimet e këtij plani. Autoriteti kompetent shkëmben informacion dhe bashkërendon zhvillimin dhe zbatimin e kritereve të rrezikut të përmendura në pikën 3 të këtij neni me autoritetet kompetente të shteteve anëtare dhe me Komisionin e BE, për të përmirësuar efektivitetin e zbatimit të këtij vendimi.
6. Autoriteti kompetent sigurohet që kontrollet vjetore të kryera sipas pikës 1 të këtij neni të mbulojnë të paktën 3 për qind të operatorëve, operatorëve pasues dhe tregtarëve jo-NVM që hedhin në treg, vënë në dispozicion në treg ose eksportojnë produkte përkatëse që përmbajnë ose janë prodhuar duke përdorur mallra përkatëse të prodhuara në vende ose pjesë të tyre të klasifikuara me rrezik standard, sipas nenit 28 të këtij vendimi.
7. Autoriteti kompetent sigurohet që kontrollet vjetore të kryera sipas pikës 1 të këtij neni të mbulojnë të paktën 9 për qind të operatorëve, operatorëve pasues jo-NVM dhe tregtarëve jo-NVM që hedhin në treg, vënë në dispozicion në treg ose eksportojnë produkte përkatëse që përmbajnë ose janë prodhuar duke përdorur mallra përkatëse të prodhuara në vende ose pjesë vendesh të klasifikuara me rrezik të lartë sipas nenit 28 të

këtij vendimi, si dhe të paktën 9 për qind të sasisë së secilit produkt përkatës që përmbajnë ose janë prodhuar duke përdorur mallra përkatëse të prodhuara në një vend ose pjesë të tij të klasifikuar me rrezik të lartë sipas nenit 28 të këtij vendimi.

8. Autoriteti kompetent sigurohet që kontrollet vjetore të kryera sipas pikës 1 të këtij neni të mbulojnë të paktën 1 për qind të operatorëve, operatorëve pasues jo-NVM dhe tregtarëve jo-NVM që hedhin në treg, vënë në dispozicion në treg ose eksportojnë produkte përkatëse që përmbajnë ose janë prodhuar duke përdorur mallra përkatëse të prodhuara në vende ose pjesë vendesh të klasifikuara me rrezik të ulët sipas nenit 28 të këtij vendimi.
9. Objektivat e matshme të kontrolleve sipas pikave 6, 7 dhe 8 të këtij neni përmbushen veçmas për secilin mall përkatës. Këto objektiva llogariten duke iu referuar numrit të përgjithshëm të operatorëve, operatorëve pasues jo-NVM dhe tregtarëve jo-NVM që gjatë vitit të mëparshëm kanë hedhur në treg, vënë në dispozicion në treg ose eksportuar produkte përkatëse dhe, sipas rastit, sasisë. Operatorët konsiderohen të kontrolluar kur strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin kanë kontrolluar elementet e përcaktuara në nenin 20, pika 1, shkronjat "a" dhe "b", të këtij vendimi. Operatorët pasues dhe tregtarët konsiderohen të kontrolluar kur janë kontrolluar elementet e përcaktuara në nenin 21, pika 1, të këtij vendimi.
10. Pa cenuar kontrollet e planifikuara paraprakisht sipas pikës 3 të këtij neni, strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin kryejnë kontrolle edhe sa herë që marrin ose vihen në dijeni për informacion përkatës lidhur me një rast të mundshëm mospërputhshmërie me këtë vendim, përfshirë informacionin që buron nga shqetësimet e arsyetuara të paraqitura sipas nenit 30 të këtij vendimi.
11. Për aq sa është e lejueshme nga legjislacioni përkatës, kontrollet kryhen pa paralajmërim paraprak për operatorin, operatorin pasues ose tregtarin, përveç rasteve kur njoftimi paraprak është i nevojshëm për të siguruar efektivitetin e kontrollit.
12. Strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin informojnë pa vonesë autoritetin kompetent për aktet, konstatimet, rezultatet dhe masat e marra në kuadër të kontrolleve sipas këtij neni dhe i vënë në dispozicion çdo dokumentacion ose informacion të nevojshëm për regjistrimin e rastit dhe administrimin e informacionit përkatës. Autoriteti kompetent mban evidenca të plota për kontrollet e kryera, duke treguar veçanërisht natyrën, objektin, rezultatet e tyre dhe masat e marra në rast mospërputhshmërie. Evidencat e të gjitha kontrolleve ruhen për të paktën 10 vjet
13. Evidencat e kontrolleve të kryera sipas këtij vendimi dhe raportet mbi rezultatet e tyre përbëjnë informacion mjedisor dhe vihen në dispozicion sipas legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit dhe për informacionin mjedisor.

Neni 19

Produktet përkatëse që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme

1. Kur në bazë të kontrolleve të kryera sipas nenit 18 të këtij vendimi ose në bazë të çdo informacioni tjetër, autoriteti kompetent identifikon një situatë në të cilën ekziston një rrezik aq i lartë i mospërputhshmërisë së produkteve përkatëse me nenin 4 të këtij vendimi sa që kërkohet veprim i menjëhershëm për të parandaluar hedhjen në treg, vënien në dispozicion në treg ose eksportin e tyre, ai regjistron pa vonesë këtë konstatim në sistemin e informacionit të ngritur sipas nenit 33 të Rregullores (BE) 2023/1115.
2. Në çdo rast, kur sistemi i informacionit i ngritur sipas nenit 33 të Rregullores (BE) 2023/1115, identifikon rrezikun e lartë të mospërputhshmërisë me nenin 4 të këtij vendimi dhe informon autoritetin kompetent, ky i fundit:
   a) Sigurohet që nga strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin të merren menjëherë masat e përkohshme të parashikuara në nenin 23 të këtij vendimi, për të pezulluar hedhjen në treg ose vënien në dispozicion në treg të këtyre produkteve.
   b) Për produktet përkatëse që hyjnë në treg ose dalin nga territori doganor, kërkon nga administrata doganore pezullimin e vendosjes në qarkullim të lirë ose të eksportit, sipas nenit 26 të këtij vendimi.
3. Pezullimet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, përfundojnë brenda tre ditëve pune ose brenda 72 orëve në rastin e produkteve përkatëse që prishen, duke filluar nga momenti kur rreziku i lartë i mospërputhshmërisë identifikohet në sistemin e informacionit të ngritur sipas nenit 33 të Rregullores (BE) 2023/1115. Kur mbi bazën e rezultateve të kontrolleve të kryera brenda kësaj periudhe, autoriteti kompetent arrin në përfundimin se nevojitet kohë shtesë për të përcaktuar nëse produktet përkatëse janë në përputhje me nenin 4 të këtij vendimi, ai sigurohet që, nga strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin ose, në rastin e produkteve përkatëse që hyjnë ose dalin nga tregu, nga administrata doganore, të ruhet pezullimi për periudha shtesë prej tre ditësh pune.

Neni 20
Kontrollet ndaj operatorëve

1. Kontrollet ndaj operatorëve përfshijnë, sipas rastit:
   a) shqyrtimin e sistemit të kujdesit të duhur të operatorit, përfshirë procedurat e vlerësimit të rrezikut dhe procedurat e zbutjes së rrezikut;
   b) shqyrtimin e dokumentacionit dhe evidencave që tregojnë pajtueshmërinë e operatorit me kërkesat e këtij vendimi dhe me sistemin e kujdesit të duhur;
   c) shqyrtimin e dokumentacionit dhe evidencave që demonstrojnë se një produkt i caktuar përkatës që operatori ka hedhur ose synon të hedhë në treg, ose synon të eksportojë, është në përputhje me këtë vendim, përfshirë, kur është e zbatueshme, nëpërmjet masave të zbutjes së rrezikut.
   ç) shqyrtimin e deklaratave përkatëse të kujdesit të duhur ose, për operatorët parësorë mikro ose të vegjël, shqyrtimin e deklaratës së thjeshtuar përkatëse ose të informacionit të vënë në dispozicion nga shtetet anëtare për operatorin në sistemin e informacionit sipas nenit 33 të Rregullores (BE) 2023/1115.

2. Në rast se pas shqyrtimit sipas pikës 1, ka paqartësi, kryhen kontrolle ndaj që përfshijnë gjithashtu:
   a) shqyrtim në terren të mallrave përkatëse ose të produkteve përkatëse me qëllim verifikimin e përputhjes së tyre me dokumentacionin e përdorur për ushtrimin e kujdesit të duhur;
   b) shqyrtimin e masave korrigjuese të marra sipas nenit 24 të këtij vendimi;
   c) çdo mjet teknik dhe shkencor të përshtatshëm për të përcaktuar specien ose vendin e saktë ku është prodhuar malli ose produkti përkatës, përfshirë analiza anatomike, kimike ose të ADN-së;
   ç) çdo mjet teknik dhe shkencor të përshtatshëm për të përcaktuar nëse produktet përkatëse janë pa lidhje me shpyllëzimin, përfshirë të dhëna vëzhgimi të Tokës si ato nga programi Copernicus dhe mjetet e tij, ose nga burime të tjera përkatëse publike ose private; dhe
   d) kontrolle në vend dhe auditime në terren, përfshirë, kur është e përshtatshme, edhe në vende të treta, kur kjo bëhet e mundur nëpërmjet bashkëpunimit me autoritetet homologe ose me pëlqimin e autoriteteve të vendit përkatës.

Neni 21
Kontrollet ndaj operatorëve pasues dhe tregtarëve

1. Kontrollet ndaj operatorëve pasues dhe tregtarëve përfshijnë shqyrtimin e dokumentacionit dhe evidencave që demonstrojnë pajtueshmërinë me pikat 3 deri në 7 të nenit 7 të këtij vendimi.
2. Kur është e përshtatshme, sidomos kur shqyrtimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni kanë evidentuar paqartësi , kontrollet ndaj operatorëve pasues dhe tregtarëve mund të përfshijnë gjithashtu kontrolle në vend, përfshirë auditime në terren.

Neni 22
Kostot e kontrolleve dhe të masave

Kur nga kontrolli konstatohet mospërputhje, strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin, në përputhje me parashikimet në legjislacionin për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe me Kodin e Procedurave Administrative, ngarkojnë operatorin, operatorin pasues ose tregtarin me të gjitha kostot e arsyeshme dhe të dokumentuara që lidhen me procedurat e kontrollit, përfshirë verifikimin, testimin, magazinimin, transportin, kthimin, tërheqjen, asgjësimin ose me masa të tjera të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 23
Masat e përkohshme

1. Autoriteti kompetent sigurohet që nga strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin ose nga administrata doganore, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, të merren menjëherë masa të përkohshme të

përshtatshme dhe proporcionale për të parandaluar hedhjen në treg, vënien në dispozicion në treg ose eksportin e mallrave përkatëse ose produkteve përkatëse në fjalë, kur konstatohet një mospërputhshmëri e mundshme me këtë vendim, mbi bazën e cilësdo nga sa vijon:

a) shqyrtimi i provave ose i informacionit tjetër përkatës, përfshirë informacionin e shkëmbyer sipas nenit 17 të këtij vendimi ose shqetësimet e arsyetuara të paraqitura sipas nenit 30 të këtij vendimi;
b) kontrollet e përmendura në nenet 20 dhe 21 të këtij vendimi;
c) identifikimi i rreziqeve nga sistemi i informacionit sipas nenit 33 të Rregullores (BE) 2023/1115.

2. Masat e përkohshme sipas pikës 1 të këtij neni mund të përfshijnë, sipas rastit:
a) pezullimin e hedhjes në treg, të vënies në dispozicion në treg ose të eksportit të mallrave përkatëse ose produkteve përkatëse;
b) bllokimin, sekuestrimin ose vendosjen nën kontroll administrativ të mallrave përkatëse ose produkteve përkatëse;
c) kërkesën drejtuar administratës doganore për pezullimin e çlirimit për qarkullim të lirë ose të eksportit;
ç) çdo masë tjetër të përkohshme të nevojshme për të parandaluar qarkullimin e mallrave përkatëse ose produkteve përkatëse potencialisht në mospërputhje.
3. Strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin ose administrata doganore informojnë pa vonesë autoritetin kompetent për aktet, konstatimet, rezultatet dhe masat e marra sipas këtij neni dhe i vënë në dispozicion çdo dokumentacion ose informacion të nevojshëm për regjistrimet e nevojshme në lidhje me rastin.
4. Kur masat e përkohshme të marra lidhen me mallra ose produkte përkatëse që mund të prekin një ose më shumë shtete anëtare të BE-së, ose kur kjo është e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi, autoriteti kompetent njofton pa vonesë Komisionin Evropian dhe autoritetet kompetente të shteteve anëtare të interesuara për këto masa.

Neni 24
Masat korrigjuese në rast mospërputhjeje

1. Kur autoriteti kompetent konstaton se një operator, operator pasues ose tregtar nuk ka respektuar këtë vendim ose se një mall përkatës ose produkt përkatës është në mospërputhje, ai sigurohet që nga strukturat kompetente përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin ose nga administrata doganore, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, t'i kërkohet subjektit të marrë, brenda një afati të arsyeshëm, masa korrigjuese të përshtatshme dhe proporcionale për t'i dhënë fund mospërputhjes.
2. Masat korrigjuese sipas pikës 1 të këtij neni mund të përfshijnë, sipas rastit, të paktën njërën nga sa vijon:
a) korrigjimin e mospërputhjeve formale, në veçanti ato që lidhen me kërkesat e neneve 5 – 15 të këtij vendimi;

b) ndalimin e hedhjes në treg, të vënies në dispozicion në treg ose të eksportit të produktit përkatës;
c) tërheqjen e menjëhershme të produktit përkatës nga tregu ose kur është e aplikueshme nga përdoruesit/konsumatorët;
ç) dhurimin e produktit përkatës për qëllime bamirësie apo interesi publik, ose nëse kjo nuk është e mundur, asgjësimin, riciklimin ose trajtimin sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve.

3. Pavarësisht masave të marra dhe të zbatuara sipas pikës 2 të këtij neni, subjekti është i detyruar të trajtojë çdo mangësi në sistemin e kujdesit të duhur me synim parandalimin e rrezikut të mospërputhshmërisë së mëtejshme me këtë vendim.
4. Strukturat kompetente përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin ose administrata doganore informojnë pa vonesë autoritetin kompetent për aktet, konstatimet, rezultatet dhe masat korrigjuese të kërkuara ose të marra sipas këtij neni dhe i vënë në dispozicion çdo dokumentacion ose informacion të nevojshëm për regjistrimin e rastit dhe administrimin e informacionit të procedurës.
5. Nëse operatori, operatori pasues ose tregtari nuk ndërmerr veprimin korrigjues sipas pikës 2 të këtij neni, brenda afatit të caktuar nga strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin ose administrata doganore sipas pikës 1, ose nëse mospërputhshmëria sipas pikës 1 vazhdon pas kësaj periudhe, autoriteti kompetent sigurohet që, nga strukturat kompetente përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin ose nga administrata doganore, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, të merren masat e nevojshme për zbatimin e veprimit korrigjues të kërkuar me të gjitha mjetet që u vihen në dispozicion nga legjislacioni në fuqi.

Neni 25
Sanksionet administrative dhe masat plotësuese

1. Pa cenuar zbatimin e legjislacionit penal në fuqi, shkeljet e këtij vendimi nga operatorët, operatorët pasues dhe tregtarët dënohen me sanksione efektive, proporcionale dhe dekurajuese, në përputhje me legjislacionin në fuqi për pyjet, inspektimin, kundërvajtjet administrative, doganat dhe me parashikimet e këtij vendimi.
2. Autoriteti kompetente sigurohet që, nga strukturat kompetente përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin ose nga administrata doganore, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, të merren të gjitha masat dhe sanksionet e nevojshme ndaj operatorëve, operatorëve pasues dhe tregtarëve që shkelin këtë vendim.
3. Sanksionet dhe masat e përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni përfshijnë, sipas rastit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të paktën sa vijon:
   a) gjoba në përpjesëtim me dëmin mjedisor, vlerën e mallrave përkatëse ose produkteve përkatëse në fjalë dhe përfitimin ekonomik të realizuar nga shkelja, me rritje graduale të nivelit të tyre në rast të shkeljeve të përsëritura;
   b) konfiskimin e mallrave përkatëse ose produkteve përkatëse në fjalë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) konfiskimin e të ardhurave të realizuara nga operatori, operatori pasues ose tregtari nga transaksioni me mallrat përkatëse ose produktet përkatëse në fjalë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) ndalimin e përkohshëm të hedhjes në treg, të vënies në dispozicion në treg ose të eksportit të mallrave përkatëse dhe produkteve përkatëse, në rast të një shkeljeje serioze ose të shkeljeve të përsëritura;

d) ndalimin e ushtrimit të kujdesit të duhur të thjeshtuar sipas nenit 15 të këtij vendimi, në rast të një shkeljeje serioze ose të shkeljeve të përsëritura;

dh) detyrimin për zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar dhe rehabilitimin e zonës së dëmtuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

e) përjashtimin e përkohshëm, për aq sa lejohet nga legjislacioni në fuqi, nga procedurat e prokurimit publik dhe nga aksesi në fondet publike, përfshirë procedurat e tenderimit, grantet dhe koncesionet.

4. Strukturat kompetente përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin ose administrata doganore informojnë pa vonesë autoritetin kompetent për sanksionet dhe masat e kërkuara, të marra ose të zbatuara sipas këtij neni dhe i vënë në dispozicion çdo dokumentacion ose informacion të nevojshëm për regjistrimin e rastit dhe administrimin e informacionit përkatës.
5. Autoriteti kompetent njofton pa vonesë Komisionin Evropian për rregullat mbi sanksionet e zbatueshme sipas këtij vendimi dhe për masat e marra për zbatimin e tyre, si dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm që i prek ato.
6. Autoriteti kompetent njofton Komisionin Evropian për vendimet gjyqësore përfundimtare ndaj personave juridikë për shkelje të këtij vendimi dhe për sanksionet e vendosura ndaj tyre, brenda 30 ditëve nga data kur këto vendime marrin formë të prerë, duke marrë parasysh rregullat përkatëse për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU IV
PROCEDURAT PËR PRODUKTET PËRKATËSE QË HYJNË OSE DALIN NGA TREGU

Neni 26
Kontrollet doganore

1. Produktet përkatëse të vendosura nën procedurën doganore të çlirimit për qarkullim të lirë ose të eksportit i nënshtrohen kontrolleve dhe masave të parashikuara në këtë kre. Zbatimi i këtij kreu nuk cenon dispozitat e tjera të këtij vendimi, si dhe legjislacionin në fuqi që rregullon çlirimin për qarkullim të lirë ose eksportin e mallrave.
2. Autoriteti kompetent është përgjegjës për zbatimin e përgjithshëm të këtij vendimi në lidhje me produktet përkatëse që hyjnë në treg ose dalin nga tregu. Në përputhje me nenin 18, ai bashkërendon dhe siguron kryerjen e kontrolleve të bazuara në rrezik nga strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin, si dhe përcakton, nëpërmjet tyre, nëse produkti përkatës është në përputhje me nenin 4 të këtij vendimi.

3. Pa cenuar pikën 2 të këtij neni, administrata doganore, bazuar në e analizën e riskut dhe në përputhje me Kodin Doganor, kryen kontrolle mbi deklaratat doganore të paraqitura për produktet përkatëse që hyjnë në ose dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.
4. Numri i referencës së deklaratës së kujdesit të duhur ose identifikuesi i deklaratës së thjeshtuar, për operatorët parësorë mikro ose të vegjël, i vihet në dispozicion administratës doganore përpara çlirimit për qarkullim të lirë ose eksportit të produktit përkatës. Personi që paraqet deklaratën doganore për çlirim për qarkullim të lirë ose eksport i vë në dispozicion administratës doganore numrin e referencës ose identifikuesin përkatës. Kjo pikë nuk zbatohet për eksportin e produktit përkatës nga operatori pasues.
5. Deri në momentin kur ndërfaqja elektronike sipas nenit 28 të Rregullores (BE) 2023/1115, do të bëhet e zbatueshme për Republikën e Shqipërisë, gjatë çlirimit për qarkullim të lirë ose eksportit të një produkti përkatës, administrata doganore, për qëllime të verifikimit të pajtueshmërisë me këtë vendim, shkëmben informacion dhe bashkëpunon ngushtësisht me autoritetin kompetent, në përputhje me nenet 17 dhe 27 të këtij vendimi dhe me legjislacionin doganor në fuqi. Kur është e nevojshme, ajo merr në konsideratë informacionin e shkëmbyer dhe rezultatet e bashkëpunimit për lejimin ose moslejimin e hedhjes në qarkullim të lirë ose të eksportit.
6. Në rastin dhe nga momenti kur ndërfaqja elektronike sipas nenit 28 të Rregullores (BE) 2023/1115 zbatohet për Republikën e Shqipërisë, administrata doganore verifikon, përmes asaj ndërfaqeje elektronike, statusin që i është caktuar deklaratës përkatëse të kujdesit të duhur në sistemin e informacionit të ngritur sipas nenit 33 të Rregullores (BE) 2023/1115.
7. Në rastin dhe nga momenti kur ndërfaqja elektronike sipas nenit 28 të Rregullores (BE) 2023/1115 zbatohet për Republikën e Shqipërisë, administrata doganore pezullon, në përputhje me Kodin Doganor, hedhjen në qarkullim të lirë ose eksportin e një produkti përkatës, kur statusi në atë ndërfaqe elektronike tregon se produkti përkatës është identifikuar sipas nenit 19 (2) të këtij vendimi, si produkt që kërkon kontroll përpara futjes në territorin doganor shqiptar apo daljes prej tij.
8. Në rastin dhe nga momenti kur ndërfaqja elektronike, sipas nenit 28 të Rregullores (BE) 2023/1115, zbatohet për Republikën e Shqipërisë, kur janë përmbushur të gjitha kërkesat dhe formalitetet e tjera sipas legjislacionit në fuqi, administrata doganore lejon, në përputhje me Kodin Doganor, hedhjen në qarkullim të lirë ose eksportin e produktit përkatës që hyn ose del nga territori doganor në cilëndo nga rrethanat e mëposhtme:
   a) statusi i përmendur në pikën 6 të këtij neni nuk tregon se produkti përkatës është identifikuar, sipas nenit 19 (2) të këtij vendimi, si produkt që duhet të kontrollohet përpara se të hidhet ose vihet në dispozicion në treg apo të eksportohet;
   b) çlirimi për qarkullim të lirë ose eksporti është pezulluar sipas pikës 7 të këtij neni, por autoriteti kompetent nuk ka kërkuar ruajtjen e pezullimit sipas nenit 19 të këtij vendimi;

c) çlirimi për qarkullim të lirë ose eksporti është pezulluar sipas pikës 7 të këtij neni, por autoriteti kompetent i ka njoftuar administratës doganore se pezullimi mund të hiqet.

9. Kur autoriteti kompetent arrin në përfundimin se një produkt përkatës që hyn ose del nga tregu është në mospërputhje, ai njofton administratën doganore në përputhje me këtë vendim dhe administrata doganore, në përputhje me Kodin Doganor, nuk lejon hedhjen në qarkullim të lirë ose eksportin e atij produkti përkatës.
10. Hedhja në qarkullim të lirë ose eksporti nuk konsiderohet provë e pajtueshmërisë me këtë vendim.
11. Mënyrat dhe formati e bashkëpunimit, shkëmbimit të informacionit, koordinimit operacional dhe njoftimit ndërmjet autoritetit kompetent dhe administratës doganore për zbatimin e këtij neni mund të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të dy institucioneve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 27

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve

1. Për të mundësuar qasjen e bazuar në rrezik të përmendur në nenin 18 të këtij vendimi për produktet përkatëse që hyjnë ose dalin nga tregu dhe për të siguruar që kontrollet të jenë efektive dhe të kryhen në përputhje me këtë vendim, autoriteti kompetent dhe administrata doganore bashkëpunojnë ngushtësisht dhe shkëmbejnë informacion me njëri tjetrin dhe, sipas rastit edhe me Komisionin Evropian.
2. Administrata doganore dhe autoriteti kompetent bashkëpunojnë, në përputhje me legjislacionin doganor në fuqi, dhe shkëmbejnë informacionin e nevojshëm për përmbushjen e funksioneve të tyre sipas këtij vendimi, përfshirë edhe nëpërmjet mjeteve elektronike.
3. Administrata doganore në përputhje me legjislacionin doganor në fuqi, mund t'i komunikojë autoritetit kompetent informacionin konfidencial të marrë gjatë ushtrimit të funksioneve të saj ose informacionin e vënë në dispozicion të saj mbi bazë konfidenciale, në masën e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Kur autoriteti kompetent ka marrë informacion në përputhje me këtë nen, ai mund t'ua komunikojë atë autoriteteve kompetente të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, në përputhje me nenin 17 të këtij vendimi dhe me legjislacionin në fuqi.
5. Informacioni i lidhur me rrezikun shkëmbehet si më poshtë vijon:
   a) ndërmjet administratës doganore dhe autoriteteve doganore të shteteve anëtare të Bashkimit Europian, në përputhje me legjislacionin doganor në fuqi;
   b) ndërmjet administratës doganore dhe Komisionit Evropian, për aq sa kjo është e zbatueshme ose bëhet e detyrueshme për Republikën e Shqipërisë;
   c) ndërmjet administratës doganore dhe autoritetit kompetent, si dhe, sipas rastit, ndërmjet këtyre dhe autoriteteve kompetente të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, në masën e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

KREU V
SISTEMI I VLERESIMIT DHE BASHKEPUNIMI ME VENDET E TRETA

Neni 28
Klasifikimi i vendeve ose i pjesëve të vendeve sipas nivelit të rrezikut

1. Për qëllime të zbatimit të këtij vendimi, klasifikimi i vendeve ose i pjesëve të vendeve sipas nivelit të rrezikut merret në konsideratë dhe zbatohet në përputhje me aktet përkatëse të Bashkimit Evropian, kur dhe për aq sa ato bëhen të zbatueshme për Republikën e Shqipërisë.
2. Deri në momentin kur klasifikimi sipas pikës 1 të këtij neni bëhet i zbatueshëm për Republikën e Shqipërisë, regjimi i kujdesit të duhur të thjeshtuar nuk zbatohet dhe operatorët i nënshtrohen detyrimeve të plota të kujdesit të duhur sipas këtij vendimi.
3. Autoriteti kompetent ndjek, evidenton dhe, sipas rastit, u bën të njohura operatorëve, operatorëve pasues dhe tregtarëve klasifikimet e vendeve ose pjesëve të vendeve sipas nivelit të rrezikut, për aq sa ato janë të zbatueshme për Republikën e Shqipërisë.

Neni 29
Bashkëpunimi teknik dhe administrativ me vendet e treta

1. Autoriteti kompetent, brenda fushës së kompetencave të tij dhe në bashkëpunim me institucionet përkatëse shtetërore, mund të angazhohet në bashkëpunim teknik dhe administrativ me autoritetet kompetente ose administrative të vendeve të treta, me qëllim mbështetjen e zbatimit të këtij vendimi, promovimin e praktikave të qëndrueshme dhe përmirësimin e gjurmueshmërisë, transparencës dhe ligjshmërisë në zinxhirët e furnizimit.
2. Bashkëpunimi sipas pikës 1 të këtij neni mund të përfshijë, sipas rastit, shkëmbim informacioni, verifikime administrative, asistencë teknike dhe forma të tjera bashkëpunimi institucional, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme.

KREU VI
SHQETESIMET E ARSYETUARA DHE AKSESI NË DREJTËSI

Neni 30
Paraqitja dhe shqyrtimi i shqetësimeve të arsyetuara

1. Çdo person fizik ose juridik mund t'i paraqesë autoritetit kompetent një shqetësim të arsyetuar, kur, në bazë të rrethanave objektive, vlerëson se një ose më shumë operatorë, operatorë pasues ose tregtarë nuk respektojnë këtë vendim.